

U.K. 94/18  
dt. 07/03/2018



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**



Drejtori i Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Kërkesës për Rishqyrtim pran Autoritetit Kontraktues të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.03.2018, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Transporti i nxënësve në relacionet, sipas Lot. 1-35", me Nr. të Prok: 644 – 18 – 002 – 221, nxjerr:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të : " K.T. Visar Uka " të dt. 05.03.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " Transporti i nxënësve në relacionet, sipas Lot. 1-35 " ,
  - Lot. 33 - Transporti i nxënësve nga fshati Ashlan Lagjia Gjaka, Shyti, Sheremeti dhe Ibrahimimi në SHFMU „Mustaf Shyti" në Ashlan dhe anasjelltas;
  - Lot. 34 - Transporti i nxënësve nga fshati Ashlan Lagjia Hyseni, Azemi, Kurtaj, Bajrami dhe Ibrahimimi në SHFMU „Mustaf Shyti" në Ashlan dhe anasjelltas, dhe
  - Lot. 35 - Transporti i nxënësve nga fshati Ashlan Lagjia Segaça, Kajtazi, Beqiri, Islami në SHFMU „Mustafë Shyti" në Ashlan dhe anasjelltas, me Nr. VU644 – 18 – 002 – 221 dhe Nr. Brendshëm : 644 – 18 – 002 - 221, kundër Njoftimit për dhënie të Kontratës te AK – së, të datës 26.03.2018 te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. Anulohet vendimi i AK për dhënien e kontratës njoftimin për kontrate të publikuar me datë: 26.02.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e Prokurimit të ktheje ne Rivlersim;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net/>

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik: " K.T. Visar Uka " me datë: 05.03.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim të vendimit të A.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Transporti i nxënësve

në ralicionin sipas Lot. 1- 35” me Nr. të Prok: VU644-18-162-221, me Nr. te brendshem te prokurimit: 644 – 18 – 002 - 221., me theks të veçantë Lot. 33, 34 dhe 35.

Në Kërkesën për rishqyrtim të vendimit të A.K., e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, parashtruesi i Kërkesës konsideron se në Lot. 33, 34 dhe 35 është bërë shkelje pasi që në publikimin e numrit të nxënësve që do të transportohen nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas është lëshuar gabim në saktësinë e numrit të nxënësve, sepse, sikurse sqaron parashtruesi i Kërkesës për Rishqyrtim të vendimit të A.K., numri i nxënësve që duhen transportuar është dashur të jetë 102 nxënës dhe jo 124 nxënës, me q’rast si rrjedhojë e numrit të pasaktë të nxënësve është eliminuar në dhënjen e kontratës në njërin prej Loteve në të cilin ka aplikuar, duke theksuar se me këtë numër të nxënësve ai i ka plotësuar kriteret për fitimin e tenderit, respektivisht të Loteve në të cilat ka tenderuar. Më tej ai shton se këtë shkelje procedurale kanë qenë të qëllimshme, andaj kërkon që të anulohet Loti 33 dhe rishikimin e të njëjtit gjatë procedurës së mëtejme.

A.K. pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e parashtruesit të Kërkesës dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, dhe pasi që pranoi shpjegimin me shkrim nga Njësia Kërkuese – Drejtoria Komunale për Arsim lidhur me pretendimet e parashtruesit të Kërkesës, gjeti se Kërkesa e Op. Ek.: “ K.T. Visar Uka “ është e bazuar , për arsye se: Drejtoria Komunale për Arsim, si Njësi Kërkuese, pas kërkesës për shpjegim të rastit, ka konstatuar se gjatë përpilimit të Specifikacionit - Kërkesës për Tender të Transportit të nxënësve në shkollën “ Mustafë Shyti “ në fsh. Oshlan, ka rrjedhur gabim në llogaritjen e numri të nxënësve për Lot. 33, 34 dhe 35, më saktësisht numri i nxënësve në Kërkesë nuk përkon me numrin real të nxënësve të dorëzuar nga shkolla. Për këtë arsye Drejtoria në shpjegimin e saj me shkrim më tej thekson se e shef të nevojshme që të bëjë një planifikim të sërishëm të këtyre linjave - Loteve, sikurse u theksuan më lartë, duke i dhënë të drejtë parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara në Kërkesën e tij.

Autoriteti Kontraktues të dhënat e Drejtorisë Komunale për Arsim i mori si të besueshme dhe si bazë të mjaftueshme për të vendosur për aprovimin e Kërkesë për rishqyrtim dhe pretendimeve ankimore të Op. Ek.

Andaj, nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të LPP-së u vendos si në dispozitiv te këtij vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, parashtruesi i Kërkesës për rishqyrtim mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
K.R. nr. prot. 14-104/02-0010256/18 - datë 05/03/2018

Saranda Cakaj

Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim

Kopje: Operatorit Ekonomik;  
Të gjitha palëve te interesuara;